REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 145/17, 150/17
Datë/Datum. 07-06-2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"Komuna Ferizaj"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues – **OSHP** **Nr. 145 - 150/17.**
Nga:	**Visar Bibaj** - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Rregullimi i shtratit te lumit te Bifurkacioni dhe trotuaret pranë lumit Nerodime-projekt tre vjeçar"**, me nr. të Prokurimit: **656-16-245-521**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE- Konzerciumi : N.P.T. "MALI ART" dhe "AVDULI "SH.P.K** – Kaçanik - Prishtinë, **dhe OE, "Linda" SH.P.K,** nga Ferizaj		
Datë			**07.06.2017**

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me Ankesën e parashtruar nga OE: **Konzerciumi : N.P.T. "MALI ART" dhe "AVDULI "SH.P.K** – Kaçanik - Prishtinë, **dhe OE, "Linda" SH.P.K,** nga Ferizaj, kundër AK – **Komuna Ferizaj,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Rregullimi i shtratit te lumit te Bifurkacioni dhe trotuaret pranë lumit Nerodime-projekt tre vjeçar"** me nr. të Prokurimit: **656-16-245-521.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		30.05.2017		03.06.2017		07.06.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **18.05.2017**, OSHP, ka pranuar ankesën me nr. **145/17**, e parashtruar nga OE: **Konzerciumi: N.P.T. "Mali Art" dhe "Avduli "shpk** – Kaçanik, si dhe me daten: **22.05.2017**, OSHP, ka pranuar ankesen me nr **150/17**, nga OE **"Linda" shpk,** - Ferizaj, kundër AK - **Komuna Ferizaj,** lidhur me aktivitetin të prokurimit "**Rregullimi i shtratit te lumit Bifurkacioni dhe trotuaret pranë lumit Nerodime - projekt tre vjeqar"** me nr. të Prokurimit: **656-16-245-521**.

Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues i ka shqyrtuar dhe trajtuar pretendimet anlimore per lëndën e (AK) –**Komuna Ferizaj.**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues Konzerciumi : N.P.T. "MALI ART" dhe "AVDULI "SH.P.K – Kaçanik.

Pikat e Ankesës nga OE **Konzerciumi : N.P.T. "MALI ART" dhe "AVDULI "SH.P.K** – Kaçanik - Prishtinë

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

Neni 1, paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së (Qëllimi).
Neni 7 i LPP-së (Barazia në trajtim dhe/jo diskriminim)
Neni 57 i LPP-së (Sigurimi i tenderit)
Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlersimi dhe krahasimi i tenderëve)
Neni 60 i LPP-së (Kriterët e dhënjes së kontratës)
Neni 65 i LPP-së (Pranueshmeria e kandidatëve ose tenderuesëve)
Neni 66 i LPP-së (Përshtatshmëria profesionale)
Neni 72 i LPP-së (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë)

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Ne vazhdim ju prezantojm faktet dhe argumentet i per gabimet dhe shkeljet e Autoritetit Kontraktues per Tenderin" Rregullimi i shtratit të lumit te Bifurkacioni dhe trotuaret pranë lumit Nerodime-projrkt tre vjeqar". te udhehequr nga Departamenti i Prokurimit , te cilat Komuna Ferizajit duhet ti marr parasysh .

Kompania jone , Konzerciumi NPT MALI ART dhe AVDULI SHPK me date 08.05.2017 ka marr Letren Standartde per tenderusin e elimimuar nga Autoriteti Kontraktues dhe me date 10.05.2017 kemi bere Kerkese per Rishqyrtim te ofertes tek Autoriteti Kontraktues , e cila Kerkese na eshte refuzuar si e pa baze per arsyet e njejta sikurse ne letren Standarte per tenderusin e eliminuar.

Pas ri-shikimit detal te DT neve jemi te sigurt se:

- Eleminimi nga AK (Komuna Ferizaj) duke u bazuar ne vendimin e OSHP-se nr.68/17, dt. 13.04.2017 nuk eshte i drejte sepse vendimi i OSHP- se eshte pjesrisht i bazuar dhe lenden e kthen ne Rivlersim, qe Rivlersim do te thot kthimi ne gjendjen fillestare , qe procesi i rivlersimit te DT te filloj nga pika zero, e qe AK duhet ti zbatoj Dispozitat dhe Nenet e cekura me larte , te cilat neve mendojm se nuk i ka zbatuar duke na demtuar neve dhe favorizuar Konz: "Pro & Co group" dhe "Kema company". ShPK

Arsyet e cekura ne kete vendim te OSHP-se jane ne kundershtim me vendimin e OSHP-se nr.421/16 dhe 437/16 , dt.30.12.2016, qe sipas keti vendimi keto dokumenta jane ne rregull dhe jane aprovuar si nga ana e Ekspertit Shqyrtues po ashtu edhe nga ana e panelit te OSHP-se e qe bien ne kundershtim me vendimin e tanishem edhe pse edhe sipas vendimit te tanishem Eksperti Shqyrtues prap ka mbrojtur ekspertizen e tij qe keto dokumenta jane ne DT dhe i plotsojn kushtet e kerkuara ne DT po ndryshimi ne mes vendimeve te kunderta te OSHP-se per probleme te njejta eshte se tani kane ndryshuar antaret e panelit te OSHP-se qe eshte ne kundershtim me ligjin, sepse per lenden e njejte edhe paneli i OSHP-se duhet te jete i njejte, por kjo duket qe eshte bere me qellim per favore te ndryshme.

Kompania jone qe nga themelimi i hershem gjate gjithe kohes eshte marre me veprimtari te tilla te puneve duke perfshi ndertimin e shtratit te lumenjeve dhe totuareve te ndryshme , ujesjelles dhe kanalizime sipas kerkese ne DT.

E njejta padrejtesi na eshte bere dhe ne vitin 2013 kur neve kemi qene me te liret ne hapjen e tenderit per projektin e njejte (faza e pare) dhe i njejtei AK (Komuna Ferizaj) e ka mbajtur pezull tenderin dhe pas nje peridhe kohore e ka anuluar aktivitetin e prokurimit duke mos na shperblyer neve me kontrate per arsye te tyre subjektive . Neve nuk kemi bere ankese fare nga presionet e ndryshme dhe parregullsit e AK (Komuna Ferizaj)

I njejti tender eshte shpallur prap dhe eshte shperblyer me kontrate OP (Linda shpk)dhe ne heren e dyte neve nuk kemi marr pjese ne tender sepse nuk kishte zbatim te LPP-se per vlersimin e tenderve dhe kishin ambicje per shperblim me kontrate per OP Linda shpk per te cilen arsye edhe u anulua tenderi heren e pare .

Sipas mendimit profesional te perfaqesuesve te Konzerciumi NPT MALI ART dhe AVDULI SHPK , Komuna e Ferizajit ne permbylljen e ketij aktvendimi te prokurimit ka bere shkelje te dispozitave ligjore qe parashihen ne Ligjin e Prokurimit Publik te Kosoves, duke ditur qe OSHP-ja lenden e ka kthyer ne rivlersim dhe nuk e ka rekomanduar perfitusin, ne baze te kesaj AK eshte dashur qe ofertuesit t'i trajtoj te barabart ofertat t'i shqyrtoj duke filluar nga pika zero dhe duke respektuar te gjitha dispozitat ligjore apo edhe te kerkoj Interpretim ligjor tek KRPP-ja, ne rast se gjerat nuk i kane shume te qarta , por AK nuk ka respektuar ligjet e LPP-se dhe na ka eliminuar padrejtesisht nga tenderi.

Pikat e ankese nga ana jone jane si vijon :

i dhe paneli i OSHP-se ne vendimin e pare

Eshte shkelur neni 1 i LPP-së –(Qëllimi i ligjit)- Qëllimi ikëtij ligji është të siguroj mënyrën më

efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike,burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

Eshte shkelur neni 7 i LPP-së (Barazia ne Trajtim / Jo - Diskriminimi), sepse Autoriteti Kontraktues me kete rast na ka vu ne pozit te pabarabart dhe diskriminuese me kete veprim, sepse konzerciumi jone per kete aktivitet te prokurimit ka dorzuar tender te pergjegjshem me çmimin me te ulet sipas radhitjes se ofertave nga Proces Verbali i Hapjes , kurse kontrata i eshte dhene tenderuesit Konz: "Pro & Co group" dhe "Kema company". ShPK me çmimin me te larte.

Neni 57 i LPP-së -(Sigurimi i Tenderit), neve kemi bere Sigurimin e Tenderit qe i ploteson te gjitha kerkesat sipas DT e qe jane aprovuar edhe nga Eksperti Shqyrtues ne dy ekspertizat e tij si dhe nga paneli i OSHP-se ne heren e pare , edhe pse nga praktika dhe ne pergjigjen qe kemi marr nga zyrtaret ligjore te KRPP-se e dim qe sigurimi i tenderit eshte pranuar nga AK edhe kur ka qene ne emer te partnerit te konzerciumit e ne rastin tone eshte plotsisht i pranushem sepse eshte ne emer te liderit, me interes per AK eshte qe sigurimi i tenderit i ka plotsuar te gjitha kritetret sipas DT. sipas pergjigjes nga Zyrtari ligjore i KRPP-se sigurimi jone i ofertes se tenderit eshte plotesisht i pranueshem dhe ne perputhshmeri me ligjin !

Eshte shkelur neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi , Vlersimi dhe Krahasimi i Tendereve), ku Autoriteti Kontraktues do ta konsideroj nje tender si te pergjegjshem vetem nese tenderi ne fjale eshte ne perputhshmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne DT , kurse AT Kontraktues ka shpallur fitues Konz: "Pro & Co group" dhe "Kema company". ShPK me çmimin me te larte dhe jo neve qe kemi qene me çmimin me te ulet sipas proces verbalit te hapjes se tenderit.

Eshte shkelur neni 60 i LPP-së (Kriteret per Dhenien e Kontrates Perkatesisht Dosja e Tenderit Seksioni II. Fleta e te Dhenave te tenderit (FDT), Kriteret e Dhenies pika 31.1

Autoriteti Kontraktues do t'i jap kontraten publike operatorit ekonomik qe ka dorzuar : tenderin e pergjegjshem me çmimin me te ulet ;

Ketu Autoriteti Kontraktues , nuk e ka respektuar kriterin e dhene per te na shpallur neve fitues , por kontrata i eshte dhene tenderusit qe ka dorzuar tenderin me çmimin shume me te larte

Neni 65 i LPP-së -(Pranueshmëria eKandidatëveose Tenderuesve), kete nene duhet ta kishit shqyrtuar qysh heren e pare sepse tani jeni shume te vonuar.

Neni 66 i LPP-së -(Përshtatshmëria Profesionale) -Qertifikat e Biznesit i plotson te gjitha kushtet sipas DT e qe eshte vertetuar nga eksperti shqyrtues dhe paneli I OSHP-sPikat e ankese nga ana jone jane si vijon :

i dhe paneli i OSHP-se ne vendimin e pare

Eshte shkelur neni 1 i LPP-së –(Qëllimi i ligjit)- Qëllimi ikëtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike,burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

Eshte shkelur neni 7 i LPP-së (Barazia ne Trajtim / Jo - Diskriminimi), sepse Autoriteti Kontraktues me kete rast na ka vu ne pozit te pabarabart dhe diskriminuese me kete veprim, sepse konzerciumi jone per kete aktivitet te prokurimit ka dorzuar tender te pergjegjshem me çmimin me te ulet sipas

radhitjes se ofertave nga Proces Verbali i Hapjes , kurse kontrata i eshte dhene tenderuesit Konz: "Pro & Co group" dhe "Kema company". ShPK me çmimin me te larte.

Neni 57 i LPP-së -(Sigurimi i Tenderit), neve kemi bere Sigurimin e Tenderit qe i ploteson te gjitha kerkesat sipas DT e qe jane aprovuar edhe nga Eksperti Shqyrtues ne dy ekspertizat e tij si dhe nga paneli i OSHP-se ne heren e pare , edhe pse nga praktika dhe ne pergjigjen qe kemi marr nga zyrtaret ligjore te KRPP-se e dim qe sigurimi i tenderit eshte pranuar nga AK edhe kur ka qene ne emer te partnerit te konzerciumit e ne rastin tone eshte plotsisht i pranushem sepse eshte ne emer te liderit, me interes per AK eshte qe sigurimi i tenderit i ka plotsuar te gjitha kritetret sipas DT. sipas pergjigjes nga Zyrtari ligjore i KRPP-se sigurimi jone i ofertes se tenderit eshte plotesisht i pranueshem dhe ne perputhshmeri me ligjin !

Eshte shkelur neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi , Vlersimi dhe Krahasimi i Tendereve), ku Autoriteti Kontraktues do ta konsideroj nje tender si te pergjegjshem vetem nese tenderi ne fjale eshte ne perputhshmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne DT , kurse AT Kontraktues ka shpallur fitues Konz: "Pro & Co group" dhe "Kema company". ShPK me çmimin me te larte dhe jo neve qe kemi qene me çmimin me te ulet sipas proces verbalit te hapjes se tenderit.

Eshte shkelur neni 60 i LPP-së (Kriteret per Dhenien e Kontrates Perkatesisht Dosja e Tenderit Seksioni II. Fleta e te Dhenave te tenderit (FDT), Kriteret e Dhenies pika 31.1

Autoriteti Kontraktues do t'i jap kontraten publike operatorit ekonomik qe ka dorzuar : tenderin e pergjegjshem me çmimin me te ulet ;

Ketu Autoriteti Kontraktues , nuk e ka respektuar kriterin e dhene per te na shpallur neve fitues , por kontrata i eshte dhene tenderusit qe ka dorzuar tenderin me çmimin shume me te larte

Neni 65 i LPP-së -(Pranueshmëria eKandidatëveose Tenderuesve), kete nene duhet ta kishit shqyrtuar qysh heren e pare sepse tani jeni shume te vonuar.

Neni 66 i LPP-së -(Përshtatshmëria Profesionale) -Qertifikat e Biznesit i plotson te gjitha kushtet sipas DT e qe eshte vertetuar nga eksperti shqyrtues dhe paneli i OSHP-se në vendimin e pare.

- Eshte shkelur neni 72 i LPP-së (Dokumentacioni dhe Informacioni shtese) ne

perputhje me paragrafin 1,2 dhe 3 ku lejohet qe :

Paragrafi 1. Kur informacioni apo dokumentacioni qe duhet dorzohet nga operatoret ekonomik eshte ose duket te jete jo i plote ose i gabuar , ose kur mungojn dokumentet specifike , autoriteti kontraktues mund te kerkoj nga operatoret ekonomik qe te dorzojn , plotsojn , sqarojn apo kompletojn informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda nje afati te caktuar kohore , me kusht qe kerkesat e tilla behen ne perputhje te plote me parimet e trajtimit te barabart dhe transparent.

Paragrafi 2. Autoriteti kontraktues mund te ftoj operatoret ekonomik per te plotsuar apo te qartesoj qertifikatat apo dokumentat e paraqitura ne pajtim me nenet 65-71 te ketij ligji.

Paragrafi 3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do te aplikohet vetem per dokumentet ekzistenca e te cilave eshte e fiksuar, para skadimit te afatit per dorzimin e tendereve , dhe

mund te vertetohet ne menyre objektive .

- Po ashtu pretendimi i ofertes financiare i plotson te gjitha kushtet sipas DT qe eshte vertetuar nga eksperti shqyrtues ne dy vendimet dhe eshte pranuar nga paneli i OSHP-se ne vendimin e pare. Po ashtu edhe per kete problem nga Zyrtari ligjore i KRPP-se kemi pergjigje se oferta financiare i plotson te gjitha kerkesat sipas DT

- Kurse sa i perket referencave , neve i plotsojm edhe kete kritere sepse referencat tona i plotsojn te gjitha kushtet sipas kerkesave ne DT e qe eshte vertetuar edhe nga eksperti shqyrtues ne dy vendimet e te vertetuara edhe nga paneli i OSHP-se ne vendimin e pare.

Autoriteti Kontraktues - Komuna Ferizaj me kete rast ka bere shkelje te Neneve te LPPsë sepse nje veprim i tille e ka favorizuar Konz: "Pro & Co group" dhe "Kema company" ShPK dhe na ka demtuar padrejtesisht neve (Konzerciumi NPT MALI ART dhe AVDULI SHPK)duke u shkelur parimi i trajtimit te barabart dhe te transparences per te kerkuar sqarim dhe plotsimin e dokumentacionit. Me keto menyra te vlersimit te tenderve sikurse te AK (Komuna Ferizaj) po damtohemi neve moralisht dhe materialisht dhe na detyron te pushojm se punuari duke pasur pasoja edhe ne uljen e fuqis puntore dhe krijimin e varferise te familjet e te punesuarve tane, dhe ne te njejten kohe shperblimin me pune te kompanive padrejtesisht dhe demtimin e buxhetit te shtetit.

Pas ketyre argumenteve te prezantuara per parregullesi dhe shkeljet e cekura nepermjet kesaj ankese , kerkojm nga Organi Shqyrtues i Prokurimit , ta aprovoj ankesen tone , te marr vendim mbi anulimin e njoftimit mbi dhenien e kontrates dhe aktiviteti i prokurimit per tenderin : Rregullimi i shtratit të lumit te Bifurkacioni dhe trotuaret pranë lumit Nerodime-projrkt tre vjeqar,te kthehet ne RI VLERSIM dhe te shpallet fitues kompania jone : Konzerciumi NPT MALI ART dhe AVDULI SHPK si oferte e PERGJEGJSHME ME QMIMIN ME TE ULET

Demi Material Konzerciumi NPT MALI ART dhe AVDULI SHPK konsideron se menyra e eleminimit nga konkurrenca dhe mos respektimi i LLP-se gjate vlersimit te tendereve . na ka detyruar te angazhojme zyrtare dhe ekspert duke shkaktuar shpenzime ne pergaditjen e Kerkeses per Rishqyrtim , Ankeses per OSHP dhe per pergaditjen dhe hargjimin e kohes per pjesmarrje ne kete tender te cilat jane baze e shkaktimit te demit material dhe jo material,

***Pikat e Ankesës nga OE* "Linda" SH.P.K, nga Ferizaj**

Neni 1, paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së (Qëllimi).
Neni 7 i LPP-së (Barazia në trajtim dhe/jo diskriminim)
Neni 57 i LPP-së (Sigurimi i tenderit)
Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlersimi dhe krahasimi i tenderëve)
Neni 60 i LPP-së (Kriterët e dhënjes së kontratës)
Neni 61 i LPP-së (Tenderi jo normalisht i ulet)
Neni 65 i LPP-së (Pranueshmeria e kandidatëve ose tenderuesëve)
Neni 108 A i LPP-së (Zgjidhja preliminare e mosmarveshjes)

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Autoriteti kontraktues gjate vlerësimit, ekzaminimit te ofertave per kete aktivitetit te prokurimit ka vepruar ne kundershtim me nenin 59.4 te LPP-SW duke i rekomanduar per dhenien e kontrates OE ne konzercium "Pro&Co Grup dhe Kema Company", pasi qe i njejti konzerciumi ne fjale eshte i papergjegjshem duke u bazuar ne kriteret e kerkuara ne dosjen e tenderit dhe njoftimit per kontrat si ne vijim:

OE i rekomanduar per kontrat eshte i papergjegjshem ne baze te nenit 65 te LPP-se si dhe kritereve te kerkuar ne lidhje me Pershtatshmerin profesionale duke u bazuar ne ate se i njejti NUK eshte i kualifikuar per kryerjen e puneve te njejta sic kerkohet ne kete aktivitet te prokurimit, kete e bazojme ne baze te certifikates se biznesit te cilen gjindet ne oferten origjinal te ketij OE , pasi kode per kryerjen e ketyre pune specifike i mungojn ne certifikaten e biznesit dhe si e tille e deshmon se i net OE i rekomanduar per kontrat NUK eshte i pershtashem profesionalisht per kryerjen e ketyre pune, poashtu je vlen te theksohet se arsyeja e kerkeses se FDT dhe njoftimit per kontrat ne lidhje me kerkesen sa i perket certifikaten e biznesit eshte e posaqerisht kerkes me te cilen duhet te deshmohet aftesia profesionale per kryerjen e pune, sherbime apo furnizimeve te ngjashme.

OE i rekomanduar per kontrat i njejti NUK ka ofruar sigurin e tenderit ne harmoni me nenin 57 te LPP-se, pasi qe polisa e sigurimit te ofertes eshte ofruar vetem ne emet te OE "Pro&Grup, dhe ne rastin konkret kemi te bejme me konzercium dhe ne policen e sigurimit te ofertes duhet te shenohet dhe leshohet sipas emrit te konzerciumit dhe jo vetem ne emrin e OE "PročzGrup" pasi qe i njejti ka konkuruar ne konzercium dhe jo i vetem, kjo eshte shume e rendesishme per faktin ne rast te rrethanave qe mundet te paraqitem per konfiskimin e kesaj police te sigurimit si e tille NUK mund te ekzekutohet pasi qe eshte leshuar ne kundershtim me rrethanet faktike sepse NUK kemi te bejme me nje OE qe ka aplikuar i vetem ne kete procedur te prokurimit por kemi te bejme me konzercium.

AK-ja ka vepruar ne kundershtim me kriterin per dhenien e kontrates siq eshte parapare ne FDT dhe njoftimit per kontrat, tenderi pergjegjshem cmimi me i ulet, lidhur me nenin 60.1.1 te LPP-se, per faktin se OE i rekomanduar per kontrat eshte i papergjegjshem, ne baze te pikave te larte cekura dhe i njejti OE rekomanduar per kontrate nuk vije ne shprehje cmimi i tij pasi kemi te bejme me oferte te papergjegjshme.

AK-ja ka vepruar ne kundershtim me nenin 7 te LPP-se , duke rekomanduar per kontrat nje OE te papergjegjshem, dhe ne rastin konkret ka bere favorizim te OE te rekomnduar per kontrat pasi qe i njejti eshte i papergjegjshem dhe eshte dashur qe oferta e tij te refuzohet dhe jo te rekomandohet per kontrat, andaj AK-ja duke na diskriminuar OF-te te tjere pjesemarres ne kete aktivitet te prokurimit, posaqestish ne si operator pasi qe ne jemi diskriminuar si OE i pergjegjshem me cmim me te ulet.

AK-ja ka vepruar ne kundershtim me nenin 61 te LPP-se sepse i njejti OE i rekomanduar eshte i papergjegjshem edhe ne baze te cmimeve qe ka ofruar per pozicione te caktuar.

AK-ja ka vepruar ne kundershtim me nenin 69 duke rekomanduar per kontrate OE te pa pergjegjshem pasi i njejti nuk posedon kontrata dhe referenca adekuate sic kerkohet ne DT dhe ne njoftimin per kontrate gjate tri (3) viteve te fundit 20132015 sepaku dy (2) projekte te ngjajshe per kete aktivitet te prokurimit.

AK-ja ka vepruar ne kundershtim me neinin 108A te LPP-se, duke e neglizhuar kerkesen per ryshqirtim dhe duke mos respektuar afetet ligjore te percaktuar me LPP, dhe ne kete raste ne si OE kemi dorzuar kerkesen per rishqyrtim pran AK me date 11/05/2017 ndersa vendimin nga AK per

refuzim e kemi pranuar me daten 17/05/2017.

AK-ja ne kete raste pa te drejt na ka eliminuar nga kjo procedur e prokurmit me pretendimin se ne si OE kemi dorzuar formularin C dhe deklaraten nen betim ne kundershtim me nenin 65 pika 3.1 te LPP-se, por qe formualari C dhe deklarata | nen betim eshte ne harmoni me nenin 65 pika 3.1 pasi qe formulari dhe deklarata i nen betim eshte nene shkruar nga menaxheri i kompanis i cili eshte legjitim dhe eshte i percaktuar edhe me certifikat te biznesit e cila gjendet ne dosjen e tenderit. Poashtu ne si OE me te nejtin autotitet kontraktues kemi nenshkruar mbi njëzet (60) kontrata me te njeten form te plotesimit dhe nenshkrimit te formularit C dhe deklaratës nene betim dhe po ashtu sqepaku dhjete (10) kontrata dhe referenca me po te nijetin menaxher te prokurimit, ketë e dëshmojmë me kontratat dhe referencat te cilat gjenden ne dosjen tone. Po ashtu AK-ja ne kete raste bie ne kundershtim me veteveten pasi qe ne tre vendimet e marrura per kete aktivitet te prokurimit ka tri vendime te ndryshme: Me dt 14/11/2016 na ka rekomanduar për kontrates per këtë aktivitet te prokurimit, Me dt 22/02/2017 na ka shpallur te pergjegjshem por te pa sukseshem, Dhe krejt ne fund dt 08/05/207 na ka shpallur te pa pergjegjshem.

Sa i perkete OE me cmimin me te lire"Mali i Art& Avduli' ky operator e konomik eshte i papergjegjshem duke u bazuar ne VENDIMIN e Organit shqyrtues te Prokurimit Publik te dates 13/04/2017

Sa i perkert OE te trete (3)"Rahovica Komerc" i rradhitur ne baze te procesverbalit te hapjes, i njeti OE nuk i eshte pergjigjur kerkeses se AK per vazhdim te validitetit te ofertave, dhe ne kete raste eshte i pa pergjegjsem.

Prandaj duke u bazuar ne te gjitha qe u ceken me larte mendojme se kjo procedur e prokurimit gjegjesishte njoftimi per dhenje te kontrates nuk eshte bere sipas LPP-se dhe kekojme nga OSHP qe kjo lende te kthehet ne Rivlersim.

Dëmet materiale

Shkeljet e supozuara mua do te me shkaktojne deme si nga aspekti kohore ashtu edhe nga aspekti materialper faktin se ne si operator ekonomik kemi qene te rekomanduar dhe te njoftuar si operator ekonomik fitues te kesaj procedure te prokurimit, dhe po ashtu ne si operator ekonomik kemi bere te gjitha pergaditjet per fillimin e punimeve dhe nje kohesishte kemi bere kerkesat per furnizimet te cilat jane te nderlidhura me kete aktivitet te prokurimit.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	05.10.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Pune/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, pas szgjatjes se afatit,	25.10.2016
Afati i parapare per hapje te ofertave, pas zgjatjes,	25.10.2016
Data e njoftimit per dhenje te kontrtes pas ri vleresimit 2	11.05.2017

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklarata nën betim se OE, i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë sipas kërkesave të LPP- së neni 65

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit.

Për OE fitues kërkohet që para shpërblimit të kontratës të dorëzoj:

- Vërtetimi mbi kryerjen e obligimeve ndaj ATK-(për tremujorin e fundit të vitit *[deri ne datën e publikimit të Njoftimit per dheni te kontrates]*

Vërtetimi mbi kryerjen e obligimeve ndaj KK-së (për vitin 2015)

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Çertifikata e Biznesit për veprimtari adekuate,
2. Çertifikata e numrit fiskal,
3. Çertifikata e TVSH-së,

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopje e Çertifikates se Biznesit për veprimtari adekuate,
2. Kopje e Çertifikates se numrit fiskal,

Kopje e Çertifikates se TVSH-së,

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar - N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Operatori ekonomik duhet te ofroje se paku 2 (dy) projekte te ngjashme për kryerjen e punëve adekuate në tri vitet e fundit (2013-2015).
2. Çertifikata ISO-9001:2008
3. Stafi profesional:
   a. Një inxhinier i ndërtimtarisë (diplome universitare, kontrate pune)
   b. Një gjeodet të licencuar, (licence valide, diplome universitare, kontrate pune)
   c. Një hidro-inxhinjer (diplome universitare, kontrate pune)

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Listën e projekteve Operatori ekonomik duhet te ofroje se paku 2 (dy) projekte te ngjashme për kryerjen e punëve adekuate në tri vitet e fundit (2013-2015) të argumentuara me 2 (dy) referenca apo raporte te pranimeve teknike për projektet të cilat i sjellë.
2. Çertifikata ISO-9001:2008 (kopje te vërtetuara) .

   3. Stafi profesional:
   a. Një inxhinier i ndërtimtarisë, të argumentuar me diplomë universitare (kopje të vërtetuar - origjinal) dhe kontratë të punës valide,
   b. Një gjeodet të argumentuar me licencë valide, diplomë dhe kontratë të punës valide. Licenca dhe diploma duhet të ofrohen kopje të vertetuara – origjinal
   c. Një hidro-inxhinjer të argumentuar me licencë valide, diplomë dhe kontratë të punës valide. Licenca dhe diploma duhet të ofrohen kopje të vertetuara – origjinal

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Lubeteni & El-bau"	Podujev	280,075.80 €	JO
2.	"Linda"shpk	Ferizaj	269,888.88 €	JO

3.	"Mali Art & Avdili shpk"	Kaqanik	249,696.30 €	JO
4.	NT"Rahovica Comerc"	Ferizaj	268,157.40 €	JO
5.	"Pro-co-grup & Kema Kompani"	Lipjan	251,093.83 €	JO
6.	"Gerlica Company"	Ferizaj	368,984.31 €	JO
7.	"Arlindi & Berisha Company"	Ferizaj	319,889.86 €	JO
8.	""Atc-Com & Kushtrimi & Yli dekor"	Viti	291,388.80 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 25.10.2016, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë katërmbëdhjetë (8) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit –Ganimete Kamishi
- - Anëtar i komisionit - Skender Baftiu
- - Anëtar i komisionit – Lulzim Shabani

Data e mbarimit të vlerësimit: 26.10.2016

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....26.10.2016

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vleresues propozon dhenjen e kontrates kompanise : LINDA SHPK, si tenderues teknikisht i pergjegjeshem dhe me cmimin me t e ulet.

Komisioni ri vlerësues 2 pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit ri vlerësues 2.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Ilir Beqiri
- - Anëtar i komisionit - Nazim Musliu
- - Anëtar i komisionit – Ismail Mehmeti

Data e mbarimit të vlerësimit: 02.05.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....02.05.2017

Raporti i komisionit ri vlerësues -2:

Per dhenje te kontrates propozohet OE "Konzorciumi "Pro & Co Group" shpk dhe "Kema Company" pasi qe ka qene e kompletuar ,e dokumentacionin e kerkuar dhe ka ofruar cmimin me te ulet i cili ka qene edhe kriter per dhenjen e kontrates.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues - (N. 306)

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi hyres Autoriteti Kontraktues - **"Komuna Ferizaj"**, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë, kontratë publike me vlerë të mesme, operatori ekonomik ankues: NPT **"Mali Art & Avduli"shpk,** dhe OE **"Linda"shpk,** kanë paraqitur ankesa kundër njoftimit për dhënje të kontrates par ri-vleresimit të ofertave , gjegjësisht kundër arsyetimeve të eleminimit te theksuara tek letrat standarde.

- Kundrejt ofertës së OE NPT **"Mali Art & Avduli"shpk,** AK, në letër standarde par ri-vleresimit të ofertave ka potencuar: *"Ju jeni eleminuar në bazë të vendimit të OSHP-së nr. 68/17, dt 13.04.2017"*.
- Ndërsa kundrejt **OE "Linda"shpk,** poashtu ne leter standarde si arsyetim te eleminimit AK ka potencuar: *"Ju keni plotesuar formularin C dhe deklaraten nën betim në kundërshtim me nenin 65, pika 3.1 të LPP-së nr. 04/L-042"*.

Kundër arsyetimeve të lartë përmendura, parashtruesit e ankesave të lartë përmendur kanë paraqitur ankesa pranë AK-së, konkretisht OE NPT **"Mali Art & Avduli"**shpk, sipas pershkrimit më datën **10.05.2015**, me pretendimet ankimore se nuk është respektuar nenin 1, 7, 57, 59, 60, 65, 66 dhe 72, i LPP-së, Ndërsa OE "Linda" shpk, me daten **11.05.2017**, duke pretenduar se është bërë shkelje e nenit 1, 6, 7, 59, 60, 61, 65, 57 dhe 69, të LPP-së.

- Kundrejt kërkesave të lartë përmendura AK- Komuna Ferizaj, nxjerr Vendime veq e vqe dhe refuzon kërkesat si të pa bazuara me arsyetime si në letra standarde, megjithatë kundrejt kërkeses së OE "Linda"shpk, e cila përmban datën **11.05.2017**, AK, nuk ka respektuar rregullat për nxjerrje të vendimit siq parashifet me nenin 108/A, të LPP-së së amandamentuar, pasi që vendimi përmban datën **17.05.2017**, nxjerr vendim (pretendim ankimre i OE "Linda"shpk).

Sqarimi nr. 1. Filimisht sqarojme pretendimet ankimre të konsorsiumit NPT "Mali Art & Avduli" shpk. Sipas deklaratës ne ankesë i njejti OE ne pergjithesi i referohet vendimeve te PSH-së, atijë me nr. **421 - 437/16**, të datës **30.12.2016**, ku potencon se i njejti vendim ka kualifikuar si të përgjegjëshëm OE të njejte, ndersa vendimit tijeter me nr. **68/17**, i dateas **13.04.2017** , nuk është i drejtëe dhe i bazuar në teresi, pasi qe lenden e ka kthyer në ri-vleresim.

- Pothuajse të gjitha pretendimet ankimrore jane te njejta tw cilat i kemi shqyrtuar dhe trajtuar përmes raporteve paraprake si deklaratën për krijimin e konsorciumit, çertefikatat e biznesit gjegjesisht veprimtaria e përshkruar në to, si dhe polisën e sigurimit të tenderit, pjesë e ofertes se OE, "Mali Art & Avduli" shpk, rrjegjimishtë shkresat e lartë përmendura – deshmite dokumentare i kemi cilësuar si adekuate në raport me kërkesat e AK-së.

Vlerësimi ynë lidhur me atë që u tha më lartë është që ri vlerësimi i ofertave nuk realizuar sipas rregullave ligjore te aplikuara edhe per kundër faktit se vendimi i PSH-se, i dates 13.04.2017, me nr 68/17, dhe arsyetimi i të njejtit potencon se nuk është plotesuar kërkesa e nenit 11.1 e FDT-së (i referohet OE "Mali Art & Avduli" shpk), sepse nuk është ofruar deklarata e nënshkruar nga secili

anëtar, tek formulari i tenderit pjesa C, nuk figuron nënshkrimi i përsonit të autorizuar etj. AK-Komuna ferizaj, gjatë procesit të ri-vlerësimit të ofertave ka qenë dashur tëe jep argumente lidhur me përgjegjeshmërinë apo pa përgjegjëshmerin e të njejtit OE, pasi që nenin 41, par 1, i rregullave të UOPP-së, shprehimisht thotë: "*...kur një vendim për ri-vleresim të ofertes bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së përfshir një urdhër për ri-vleresim. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënjes së kontrates nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.*

Pa dashur të paragjykojme rezultatin përfundimtar po japim shembullin gjegjësisht forma tabelate e rregullave të udhezuesit operativ për prokurim publik (legjislacion sekondar i publikuar në ueb faqen e KRPP-se), trajton problemet duke sqaruar veprimet dhe ate si me poshte:

Problemi - *Mungon deklarata e qarte ku te gjithe anetaret e grupit jane bashkarisht dhe individualisht pergjegjes.*
Si të veprohet – *Mund te kerkohen informata sqaruese.*
Neni i LPP-se - *Kusht administrativ.* Ndersa AK – Komuna Ferizaj, i është referuar vendimit të PSH-se, pa bërë krahasimin e shkresave të lëndës pjesë e ofertës së OE "Mali Art & Avduli" shpk).

Sqarimi 2. Në vijim po sqarojme pretendimt ankimore të **OE "Linda"shpk**. Poashtu disa nga pretendimet e të njejtit i kemi sqaruar dhe trajtuar përmes raporteve paraprake si çertifikata dhe veprimtaria e biznesit ne raport me pozicionet e paramasës dhe parallogarisë, si dhe referencat për punë adekuate, (ateher arsyetim i eleminimit) kundrejt OE tani të rekomanduar për dhënje të kontratës, "Pro-Co Grup & Kema Kompany" gjegjësisht përmes raportit të datës 07.12.2016, kemi sqaruar se i njejti OE, ploteson kërkesën e paraparë në piken 7.1, pozicioni 1, dhe kërkesen 9.1, pozicion i 1, të FDT-së. Të njejtat pretendime janë konstatuar edhe përmes vendimit të PSH-se, nr. 421/16-437/16, të datës 30.12.2016, gjegjesisht përmes arsyetimit të të njejtit vendim.

Pretendimi tjetër i pa trajtuar më parë, lidhet me sigurimin e tenderit, të OE tani të rekomanduar për dhënje. Polisa e sigurimit, pjesë e ofertës së të njejtit OE, përmban të dhëna sipas kërkesës së AK-së të parapare në pikën **13.2**, të FDT-së, si perudhën kohore, vlerën e kërkuar, emërtimin e aktivitetit të prokurimit dhe numrin e prokurimit. Përkunder faktit se e njejta polise përmban vetëm emrin e anetarit të grupit OE "Pro & Co Group"shpk, vlerësojmë se si e tille e plotëson kërkesën e AK-së, pasi që i njejti permes deklaratës së përbashkët është përcaktuar si lider i grupit. Parashtruesi i ankesës përmes deklaratës në ankesë potencon se i njejti OE është i pa përgegjeshëm edhe në bazë të çmimeve që ka ofruar për pozicione të caktuara, mirëpo i njejti nuk ka precizuar – sqaktësuar ndonjë pozicion e që një gjë e tillë është e parapare në nenin 111, par 1.6, të LPP-së.

Pretendimi tjetër ka të bëjë me formularin C, dhe deklaraten nen betim (pretendim ankimore dhe arsyetim i eleminimit të OE "Linda"shpk pas ri-vleresimit të ofertave i cituar ne letër standarde). Lidhur me të njejtën situatë sqarojme se formulari i tenderit pjesa "C" dhe deklarat nën betim, pjese e ofertës se OE "Linda"shpk, sipas pershkrimit i përmbajn të dhënat siç kërkohet me dispozitat e LPP-së në fuqi, megjithate arsyetimi i eleminimit citon: "*Ju keni plotesuar formularin C dhe deklaraten nen betim ne kundershtim me nenin 65, pika 3.1 te LPP-se nr. 04/L-042".*

Andaj, në mbështetje të asaj që u tha më lartë, rekomandimi ynë për AK – Komuna Ferizaj, është që sipas nenit 72, të LPP-së, t'i ndermerr veprimet e nevojshme për ta udhehequr procesin e ri-vleresimit konform ligjit dhe rregullave ne fuqi, t'i rishikoj dhe ri vlerësoj ofertat e pranuara në mënyrë që të kemi një pasqyrë me reale kundrejt oferuesve. Konkretisht t'i referohet formës tabelare e paraparë në nenin 39.8, të rregullave të UOPP-së, ku trajtohen problemet, poashtu të konkretizohet – qartësohet më dëshmi doumentare, arsyetimi i eleminimit kundrejt OE "Linda"shpk, i potencuar në letër standarde "... formulari C dhe deklarata nën betim janë ofruar në kundërshtim me nenin 65, pika 3.1, e LPP-së".

Mendimi i ekspertit:

Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e cekura në raport i propozon panelit shqyrtues që aktivitetin e prokurimit me titull: "**Rregullimi i shtratit të lumit të Bifurkacionit dhe trotuarët pranë lumit Nerodime - projekt tre vjeçar**", me nr. të Prokurimit: **656 16 245 521**, të inicuar nga AK – Komuna Ferizaj ta kthej në **RI VLERESIM**, ndërsa ankesat e OE **N.P.T. "Mali Art" &"Avduli "shpk -Kaqanik, dhe OE, "Linda" shpk -** Ferizaj, të aprovohën si **të bazuara pjesërisht.**